

Nr _____ Prot

Numri i kërkesës: 673

Datë: 15-06-2022

INFORMACION PËR QYTETARIN

Përshëndetje!

Në përgjigje të kërkesës tuaj, dt. 31.05.2022 ju bëjmë me dije se:

- Zv/Drejtori i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Z. Spartak Zekja disponon diplomë të Gjuhës Italiane lëshuar nga Universiteti i Tiranës me dt. 04.07.1994. Studimet në këtë degë, Z. Zekja i ka kryer me kohë plotë në periudhën 1989-1994.

Në vitin 2015, Z. Zekja ka përfunduar studimet me kohë të pjesshme për Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Z. Zekja është regjistruar në këtë fakultet me 05.04.2011 dhe ka mbrojtur diplomën e studimeve Bachelor me 16.07.2015.

Gjithashtu Z.Zekja disponon Diplomë në Studimet Socio-Politike (studime dy-vjeçare) lëshuar me dt. 31.10.2009 nga Instituti i Formimit Politik "Pedro Arupe"

Gjatë periudhës 2017-2019 Z.Zekja ka kryer studimet dhe është diplomuar me Diplomë Master i Shkencave Sociale në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë.

- Z. Spartak Zekja është komanduar në detyrën "Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse me date 06.04.2018 dhe pas periudhes së proves është emëruar në këtë detyrë.

- Cikli Master i studimeve është ndjekur nga Z. Zekja, pa shkëputje nga puna, sipas orareve të vendosura nga Universiteti – mbasdite dhe në fundjavë – çka nuk ka ndikuar në angazhimin e z. Zekja për përmbushjen e detyrave pranë FSDKSH

- Z. Zekja është komanduar në detyrën Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Fondit, me dt. 19.05.2020 dhe pas periudhes 3 mujore ai është emëruar në këtë detyrë.

- Për tu njohur me Rregulloren e FSDKSH, ju lutem konsultohuni me faqen zyrtare të Fondit, www.fsdksh.gov.al.